

20140431251

**L I G J**  
**PËR PLOTËSIM TË LIGJIT PËR THEMELIMIN E AGJENCISË PËR PËRKRAHJE**  
**FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL**

Neni 1

Në Ligjin për themelin e Agjencisë për Përkrahje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 72/2007 dhe 5/2009) , në nenin 11 pas paragrafit 2 shtohen dy paragrafë të rinj 3 dhe 4, si vijojnë:

"Për emërimin e drejtorit publikohet shpallje publike në tre gazeta ditore të cilat botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat njëra nga gazetatat që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Drejtori mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
  - 2) në momentin e emërimit me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim apo sanksion i kundërvajtjes ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës,
  - 3) ka marrë së paku 240 kredi sipas EKTS ose ka mbaruar shkallën VII/1,
  - 4) ka së paku pesë vjet përvojë pune;
  - 5) posedon njërën nga certifikatat vijuese të njohura ndërkombëtarisht ose dëshmime për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
    - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
    - IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,
    - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
    - FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të dhënë,
    - BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë,
    - APTIS (APTIS) - së paku niveli B2 (B2) dhe
  - 6) ka të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet."
- Paragrafët 3 dhe 4 bëhen paragrafë 5 dhe 6.

Neni 2

Drejtori i Agjencisë i emëruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji vazhdon ta kryejë funksionin deri në kalimin e mandatit për të cilin është emëruar.

Neni 3

Dispozitat nga neni 1 i këtij ligji që kanë të bëjnë me kushtin për njohjen e gjuhës së huaj do të fillojnë të zbatohen pas dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", e do të fillojë të zbatohet pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.